



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

28-07-2023

01-110/05-987



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, ftesën e datës 21.07.2023, njësia Administrative Bërzhitë, Bashkia e Tiranës nenit 36. paragrafi 36.2 shkronja d), të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/49, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 27.07.2023, merr këtë:

## V E N D I M

**Për Vizit studimore në Shqipëri, shkëmbim provojave dhe thellim i mëtejshëm i bashkëpunimit në nivel Lokal në mes të dy komunave, njësia Administrative Bërzhitë, Bashkia e Tiranës dhe komuna e Vitisë**

### Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për vizit në Shqipëri, shkëmbim provojave dhe thellim i mëtejshëm i bashkëpunimit në nivel Lokal në mes të dy komunave, njësia Administrative Bërzhitë, Bashkia e Tiranës dhe komuna e Vitisë vizita do të jetë tri ditore.

### Neni 2

Mjete për këtë vizitë sigurohen nga buxheti i komunës së Vitisë programi buxhetor i kuvendit komunal, kategoria ekonomike, shërbime dhe mallra.

### Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ftesa e datës 21.07.2023, njësia Administrative Bërzhitë, Bashkia e Tiranës.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë.

### Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
K R Y E S U E S I  
Bekim Azizi